



01/Nr. 1332/2025

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, 12 paragrafi 2 shkronja (d), 40, Ligji Nr.08/L-332 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025 neni 35, Shkresën e MAPL-së me numër 020-735/2 të datës 30.12.2024, Statuti i Komunës së Hanit të Elezit neni 25, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datë 27.02.2025 merr:

### VENDIM

#### PËR CAKTIMIN E NORMAVE TATIMORE PËR TATIMIN NË PRONËN E PALUAJTSHME PËR VITIN 2025

1. Miratohet propozim vendimi me numër 04/Nr.9045/2024 për caktimin e normave tatimore për të gjitha kategoritë e pronave të paluajtshme, me përjashtim të kategorisë pronë publike të komunës së Hanit të Elezit për vitin 2025.
2. Vlerat tatimore vendosen brenda kufijve të përcaktuar si më poshtë dhe janë të vlefshme nga fillimi i vitit tatimorë 2025.

Nr.	Kategoria e pronës	Norma tatimore
1	Për njësitë bujqësore të parcelave	0.10%
2	Për njësitë bujqësore të objekteve	0.10%
3	Për njësitë pyjore të parcelave	0.10%
4	Për njësitë rezidenciale të parcelave	0.10%
5	Për njësitë rezidenciale të objekteve	0.10%
6	Për njësitë komerciale të parcelave	0.15%
7	Për njësitë komerciale të objekteve	0.20%
8	Për njësitë industriale të parcelave	0.15%
9	Për njësitë industriale të objekteve	0.20%

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Zyra e Tatimit në Pronë.
4. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas protokollimit të autoritetit mbikëqyrës dhe 7 ditë pas publikimit në ueb – faqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve,
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa,
- Zyra e Tatimit në Pronë,
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe
- Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit  
Data: 27.02.2025





Republika e Kosovës / Republic of Kosova  
Komuna - Municipality  
Hani i Elezit



01/Nr. 980/2025

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, neni 40.2 shkronja (d) , Rregulloren e Punës së Kuvendit neni 15 shkronja (c), Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datë 27.02.2025 merr:

**V E N D I M**

PËR MIRATIMIN E RAPORTIT TË PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS PËR VITIN 2024

1. Kuvendi i komunës miratoi vendimin për Raportin e Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2024.
2. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Raporti i Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2024.
3. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas protokolimit të autoritetit mbikëqyrës dhe 7 ditë pas publikimit në ueb – faqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe
- Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit  
Data: 27.02.2025







01/Nr.948/2025

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 40, 68, Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna neni 6, Statutin e Komunës së Hanit të Elezit me numër 01/Nr.4240/2023 neni 80, 81, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 27.02.2025 merr:

#### VENDIM

#### PËR PLANIN NDËRKOMUNAL PËR MENAXHIMIN E INTEGRUAR TË MBETURINAVE PËR RAJONIN E GJILANIT DHE FERIZAJIT

1. Me këtë vendim aprovohet Plani Ndërkomunal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave për Rajonin e Gjilanit dhe Ferizajt.
2. Plani Ndërkomunal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave për Rajonin e Gjilanit dhe Ferizajt lëshohet në procedurë të diskutimit publik me qytetarë.
3. Obligohet Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë që t'i zhvillojë procedurat e diskutimit publik me qytetarët dhe pas kësaj rezultate të diskutimit publik t'i paraqesin në Kuvendin e Komunës për finalizimin e Plani Ndërkomunal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave për Rajonin e Gjilanit dhe Ferizajt.
4. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Plani Ndërkomunal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave për Rajonin e Gjilanit dhe Ferizajt.
5. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas protokollimit të autoritetit mbikëqyrës dhe 7 ditë pas publikimit në ueb – faqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë,
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe
- Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit  
Data: 27.02.2025

Kryesuesi i Kuvendit  
Florim Shkreta

